



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 56, datë 07.02.2024

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 31, DATË 31.01.2024 “PËR
NUMRIN E KANDIDATËVE QË DO TË PRANOHEN NË PROGRAMIN
E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS,
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025” TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ë”, nenin 99 dhe nenin 262 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 53, pikat 2, 3 dhe 9, në nenin 55 pika 1, si dhe nenin 56, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në vendimin nr. 31, datë 31.01.2024 “Për numrin e kandidatëve që do të pranoen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 6 të vendimit nr. 31, datë 31.01.2024 si më poshtë: “gj) Të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 7 (shtatë). Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, jashtë vendit parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike. Nota mesatare e përgjithshme del nga shumatorja e notave të të gjitha lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve e pjesëtuar me numrin total të tyre.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR